



SHERBIMI SOCIAL

Buletini Informativ

Janar-Dhjetor 2024

#REATREAT



Një retreat produktiv me stafin e Shërbimit Social nga e gjithë Shqipëria, ku u diskutuan sfidat e punës së përditshme, u ndanë eksperiencat dhe ide të ndryshme. Synimi kryesor ishte rritja e standarteve dhe formimi i një vizioni të ri për të ardhmen e Shërbimit Social Shtetëror.

#FONDI SOCIAL

15 Kryetarë të Bashkive nënshkruan Marrëveshjet e Bashkëpunimit për projektet propozimet që do të mbështetën me financim për vitin 2024.

Shërbimi Social Shtetëror si hallkë kyçe e monitorimit të shërbimeve sociale, inkurajon çdo bashki të zgjerojë shërbimet egzistuese, të ngrenë shërbime sociale prioritare për komunitetin.





SHERBIMI SOCIAL

#DITA E VERËS

Dita e verës me fëmijet e familjes sonë të madhe të SHSSH, në bashkëpunim me Alo Mik, kaluan disa momente argëtuese në ambjentet e Eden Park.

Së bashku me Drejtorin e Përgjithshëm të Shërbimit Social Shtetëror znj. Reme Xholi, fëmijët kënduan, kercyen, luajtën, konkurruan dhe dhuruan perqafime plotë jetë dha dashuri mes njeri- tjetrit.



#PAK MË AFËR

#PAKmëAfër është një fushatë që ka në fokus sjelljen në vëmendje nevojave të personave me aftësi të kufizuar.

Ky aktivitet mbledhi së bashku të gjithë aktorët që punojnë në fushën e aftësisë së kufizuar, duke përfshirë ekipet shumë disiplinore, aktorët e pushtetit vendor, mjekë familje, mjekë specialistë, organizatat e shoqërisë civile dhe struktura të shërbimeve të integruara.





SHERBIMI SOCIAL

#DITA E AUTIZMIT

Një mik i veçantë i Shërbimit Social, i kërkuar nga të gjithë fëmijët tanë, Luiz Ejlli vizitoi Shtëpinë e Pëllumbave, ku këndoi dhe festoi me fëmijët tanë.

Në Qendrën e Zhvillimit “Pëllumbat” aktualisht marrin shërbime 18 fëmijë me ç’rregullimin e spektrit të autizmit.



1 QERSHOR

Momente gëzimi dhe plot dashuri pranë ëngjëjve të vegjël të Shtëpisë së Foshnjës Tiranë.

Nën kujdesin e veçantë të stafit të mrekullueshëm të Shtëpisë së Foshnjës, SHSSH dhe miqve tanë zgjodhëm të festojmë plot dashuri duke dhënë mesazhin që çdo fëmijë meriton një familje.





SHERBIMI SOCIAL

DITA PARË E SHKOLLËS

Dita e parë e shkollës është një moment i paharrueshëm për çdo fëmijë. Së bashku me Ministren e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Albana Koçiu shoqëruam fëmijet tanë në ditën e parë të shkollës.



#DITA E TË MOSHUARVE

Me gjyshat e preferuar të Qendrës Polivalente Ditore në Kamëz, ku në ditën e tyre të shënuar shkëmbyem disa përfaqime të ngrohta dhe fjalë zemre.





SHERBIMI SOCIAL

#16 DITËT E AKTIVIZIMIT KUNDËR DHUNËS

Në kuadër të 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore u mbledhëm në një rreth miqësor me miq e bashkëpunetorë të cilët marrin pjesë në zinxhirin e mundësive që u ofrohen vajzave dhe grave pasi vijnë në Qendrën e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje. Kësaj ditë ju bashkua dhe Luana Vjollca e cila ofroi një mbështetje të pakushtëzuar ndaj kauzave të tilla.



#DITA NDËRKOMBËTARE E VULLNETARIZMIT

Në Ditën Ndërkombëtare të Vullnetarizmit, nën sloganin “Mbështetje që ndryshon jetë”, pritëm në një event shumë të ngrohtë e miqësor ish- drejtues të përgjithshëm të SHSSH-së, organizata partnere, bashkëpunetorë e miq që ndër vite kanë bashkëpunuar ngushtësisht me njeri- tjetrin.





SHERBIMI SOCIAL

#KRISHLINDJE TË GËZUARA

Festa e Krishlindjes nga Familja e Madhe e Mbrojtjes Sociale, ku festuam së bashku me përfituesit e shërbimeve sociale nga qendrat ditore dhe ato rezidenciale, duke ndarë momente të ngrohta, buzëqeshje dhe gëzim.



#FAMILJA E MADHE SHSSH

Me stafet e Shërbimit Social Shtetëror nga Shkodra deri ne Vlorë, u shpërndanë me shumë dashuri pako tek gjyshërit në nevojë.

Cdo pako është një shenjë kujdesi, ndërsa secili moment ngjall emocione dhe solidaritet, duke sjellë buzëqeshje në fytyrat e atyre që më së shumti duan dashuri dhe mbështetje sot.

